

**VENDIM**  
**Nr. 240, datë 20.4.2022**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “BAGO”, BASHKIA KAVAJË,  
DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Bago”, Bashkia Kavajë, në masën 197 156 668 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 39 431 333 (tridhjetë e nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Bago”, Bashkia Kavajë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit.

3. Bashkia Kavajë caktohet si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Bago”, Bashkia Kavajë, sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**